



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në pajtim me autorizimet e dhëna me nenin nenin 113 të Ligjit Nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, në mbledhjen e rregullt të mbajtur me datë 24.11.2022, nxjerr këtë:

VENDIM

Për Miratimin e Kërkesë për Ri-destinim të Buxhetit të Programit të Zgjedhjeve për Zgjedhjet e Jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan

- I. Miratohet kërkesa për ri-destinim të buxhetit të programit të zgjedhjeve, për zgjedhjet e jashtëzakonshme për Kryetar në komunat: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan.
- II. Kërkesa për ri-destinim të buxhetit, si në pikën I është pjesë përbërse e këtij vendimi.
- III. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Prishtinë, 24.11.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve





Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Datë / Datum / Date	23.11.2022	Referencë/e	
Për/ Za / To	Këshillin për Buxhet dhe Financa		
Përmes/ Preko/ Through	Burim Ahmetaj, KE i Sekretariatit të e KQZ-së e KQZ-së		
Nga/ Od/ From	Miradije Meha, drejtoreshë e DAP-it/ZKF		
Kopje/ Kopia/ Copy			
Tema/ Subject:	Kërkesë për ri-destinim të buxhetit të programit të Zgjedhjeve për Zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar komune,		

Të nderuar anëtarë të KQZ-së,

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me Vendimin me nr. 1363 -2022 ka miratuar Buxhetin për zgjedhjet e Jashtëzakonshme për kryetar në komunat: Mitrovica e Veriut, Zubin Potok, Leposaviq dhe Zveçan për të dy raundet në shumë prej 556,483 Euro.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me numër të protokollit 1370-2022 të 15.11.2022, ka dërguar Qeverisë kërkesën për miratimin e buxhetit për zgjedhje e jashtëzakonshme për kryetar në katër komunat.

Po ashtu, sipas kërkesës së Qeverisë, më 18.11.2022 është dërguar kërkesa e dytë buxhetore në të cilën është specifikuar buxheti për raundin e parë dhe të dytë për zgjedhjet e jashtëzakonshme.

Më 18.11.2022 me vendimin 02/108 të datës 18.11.2022, Qeveria ka ndarë buxhetin KQZ-së në shumë prej 310,183 Euro nga të cilat: paga dhe shtesa 27,018 Euro, mallra dhe shërbime 281,065 Euro dhe Shpenzime komunale 2,100 Euro.

Më 22.11.2022 Thesari ka alokuar KQZ-së buxhetin e miratuar nga Qeveria.

Buxheti i ndarë për zgjedhjet e Jashtëzakonshme, në mallra dhe shërbime në vlerë prej 281,065 Euro dhe i cili është planifikuar për pagesën e trupave zgjedhore, për furnizimet me materiale zgjedhore dhe për shërbimet që kanë të bëjnë me zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në katër komunat.

Mirëpo, disa nga aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me furnizimet dhe shërbimet e për të cilat duhet të zhvillohen procedurat e tenderimit, njësitë kërkuese i kanë përgatitur specifikat për të dy raundet dhe sipas vlerësimeve nuk mund të mbulohen me buxhetin e aprovuar për raundin e parë nga Qeveria.

Për raundin e dytë , për Informimin publik KQZ-ja ka aprovuar 10,000 Euro, për Fletëvotimet 5,500 Euro dhe Distinktiv 2,340 Euro. Shuma totale e buxhetit të aprovuar për raundin e dytë e për të cilat duhet të zhvillohen procedurat e prokurimit është 17,840 Euro.

Është bërë një analizë e buxhetit të aprovuar me Ligjin e Buxhetit për vitin 2022 në Programin e Zgjedhjeve (14200) – mallra dhe shërbime në shumë prej 25,000 Euro. Buxheti ishte aprovuar për këto projekte-aktivitete:

- 9,000 Euro -Pajisja me të dhënat e reja gjeografike
- 6,000 Euro Analizë e procesit zgjedhor- trajnimi dhe
- 10,000 Euro -Informimi dhe Edukimi I votues të rijë

Buxheti i aprovuar për vitin 2022 në kategorinë e mallra dhe shërbime në programin e Zgjedhjeve për aktivitetet e cekura më lartë nuk është shpenzuar.

Vlerësojmë se nga buxheti i pa shpenzuar, mund të ridestinohet shuma prej 17,840 Euro, për zhvillimin e procedurave të prokurimit për tri aktivitetet e cekura më lart.

Nëpërmjet kësaj shkrese, kërkojmë që të shqyrtohet kërkesa për ridestinimin e buxhetit të pa shpenzuar të programit të Zgjedhjeve (kodi 14200) - mallra dhe shërbime, në vlerë prej 17,840 Euro në të njëjtin program dhe kategori për aktivitetet të cilat kanë të bëjnë me zgjedhjet e jashtëzakonshme për kryetar në katër komunat.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3 të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës, nenin 37.2 (pika c), të Ligjit Nr.03/L-040, për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 5, 6 dhe 7 të Udhëzimit Administrativ për Zëvendësimin e Anëtarit të Kuvendit Komunal, Nr.01/2017, si dhe Aktgjykimi i Gjykatës Kushtetuese, KI45/2020 dhe KI46/20, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 24.11.2022, nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. **Znj. Zejnije Velju**, emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Shtime, nga subjekti politik “Lëvizja Vetëvendosje”, duke e zëvendësuar anëtarin e Kuvendit Komunal Znj. Heroina Selmani.
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t’i komunikohet znj. Zejnije Velju dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatim..
- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka shqyrtuar shkresat e lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 21.11.2022, Nr.09/01/1402/2022, për zëvendësimin e anëtares të Kuvendit Komunal znj. Heroina Selmani, me rastin e dorëheqjes së saj, për arsye të udhëtimit jashtë vendit.

Pas shqyrtimit të kërkesës dhe shkresave të bashkangjitura, është verifikuar dhe konstatuar se, kandidatja në listën e rirenditur është znj.Zejnije Velju.

Kandidatja e radhës ka dhënë deklaratën e pranimin të mandatit, nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë, me numër më të madh të votave, duke mos tejkaluar kuotën prej 30 % , të kufirit minimal të përfaqësimit gjinor të gjinisë pakicë, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2021..

Andaj, pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

Prishtinë, 24.11.2022

Kryesues i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve



Kreshnik Radoniqi